

Në pajtim me nenin 55, paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punën e organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në pajtim me nenin 22 dhe nenin 25 të Ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i arsimit miratoi programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore **Gjuhë angleze** për vitin e **III (tretë)** të **arsimit të mesëm katërvjeçar**, për vitin shkollor 2020/21.

## 1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën e **gjuhës angleze** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura, të parapara me programin mesimor për lëndën mësimore që është realizuar në mënyrë të rregull dhe në përputhje me planin e miratuar mësimor.

Programi i shkurtuar evidenton tema të caktuara dhe njësi mësimore që do të duhet të realizohen në kuadër të 159 ditëve mësimore, duke respektuar megjithatë fondin e paraparë javor të orëve, të miratuar me programin e rregullt, përkatësisht, me programin e shkurtuar, për lëndën mësimore me 3 orë në javë, parashikohen 96 orë.

Gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore të programit të shkurtuar, mësuesi do të udhëhiqet sipas qëllimeve/rezultateve të pritura, sipas nocioneve të përcaktuar, metodave dhe aktiviteteve që janë miratuar në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyrë e komponentëve dhe shkathtësive gjuhësore<sup>1</sup>

### Komponenta 1. NJËSITË LEKSIKORE

- Vetitë e karakterit
- Mjedisi jetësor
- Përditshmëria (hobi, zbavitje, sport)
- Shëndeti dhe higjiena
- Blerja

### Komponenta 2. GRAMATIKA

- Emrat që përdoren vetëm në njëjës/shumës
- Forma kauzale (Causative have)
- Përkatësi me *of* te sendet
- Present Perfect Continuous
- Past Perfect Continuous
- Mbiemrat me një (s)
- Përemër i papërcaktuar me mbiemër/fjali krahasimore: p.sh. He gave me the largest ones. He gave me nothing.

### Komponenta 3. FUNKSIONET GJUHËSORE

- Shprehje interesimi, befasie, dakordimi/mos dakordimi, dhënie mendimi shoqëruar me argumente.

---

<sup>1</sup> Për shkak të qasjes integrale ndaj të të mësuarit në gjuhën angleze, komponentët dhe shkathtësitë e dhëna gjuhësore nuk mund të veçohen, përkatësisht, orët mësimore nuk mund të planifikohen sipas tyre.

#### **Komponenta 4. DËGJIM ME TË KUPTUAR**

- Искazi Thënie
- Tekste

#### **Komponenta 5. TË FOLURIT**

- E folur me interaksion
- Fjalë
- Fjali
- Prodhim i të folurit
- (thënie dhe të rrëfim një temë të dhënë)

#### **6. LEXIM ME TË KUPTUAR**

- Tekste (tekste më të gjatë)

#### **Komponenta 7. SHKRIMI**

- Letër zyrtare
- Letër jozyrtare
- Punim i orientuar

#### **Komponenta 8. KULTURA**

- Moda
- Ekologjia
- Trafiku
- Eventet kulturore (festime, karnavale, festivale)
- Jetë e shëndetshme (ushqim i shëndetshëm, rekreacion, mjekësi alternative)

- Turizëm

### 3. Sugjerime didaktike

Realizimi i programit të shkurtuar mësimor për lëndën e gjuhës angleze ka për bazë programin e rregullt mësimor (rezultatet nga mesimnxënia, përmbajtjet dhe konceptet, aktivitetet dhe metodat e propozuara dhe standardet e vlerësimit).

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar mësimor, qëllimi i këtyre rekomandimeve didaktike është që të ndihmojnë mësimdhënësin për të arritur qëllimet e përcaktuara duke aplikuar njohuritë më të fundit në fushën e gjuhësisë së aplikuar, pedagogjisë dhe psikologjisë, pra duke aplikuar përvojat pozitive vendore dhe të huaja lidhur me mësimdhenien dhe mësimin e gjuhës angleze, por pa ia kufizuar atij/asaj aftësinë krijuese.

Në planifikimin e mësimdhënies për vitin e parë, janë marrë parasysh përmbajtjet e programeve mësimore të lëndëve të tjera që mësohen në vitin e parë, përkatësisht, është respektuar parimi i lidhjeve ndërdisiplinore në raport me qëllimet dhe përmbajtjet, duke vënë theksin në lidhjen e integruar me përmbajtjet nga gjuha amtare.

**Për shkak të veçantisë që do të ketë ora e shkurtuar, sugjerohet që në këtë suazë kohore mësimdhënësi ta organizojë orën me një hyrje, pjesë kryesore dhe përmbyllje të duhur. Këta tre elementë të secilës orë mësimore, në fokus do të duhet të kenë: qëllimet kyçe të mësimin, të mund të kuptohen lehtë dhe të ofrojnë mundësi për të ushtruar më tej përmbajtjen e prezantuar. Mësimdhënësi duhet që në fund të secilës orë, të bëjë një përmbledhje të orës së mbajtur, duke vënë theksin mbi përmbajtjen e re dhe duke sugjeruar mësim dhe ushtrim plotësues në mënyrë të mëvetësishme.**

**Qëllimi i këtyre orientimeve është t'u jepet mundësia nxënësve që të jenë në gjendje, për t'i përvetësuar dhe ushtruar përmbajtjet e prezantuara përgjatë orës mësimore, edhe jashtë orës dhe në mënyrë të pavarur.**

**Veç kësaj, me shkurtimin e orës mësimore, mësimdhënësit i duhet të bëjë kujdes të veçantë, dhe përmbajtjen ta prezantojë në mënyrën që do u përshtatej të gjithë stileve të të mësuarit: auditiv, vizual, taktil, kinestetik. Në këtë mënyrë, çdo nxënës do të mund më shpejtë dhe do ta ketë më lehtë për të përvetësuar, kuptuar dhe zotëruar përmbajtjen e prezantuar.**

Fokusi i përqëndrimit i mësimdhënies bashkëkohore është nxënësi dhe procesi i të nxënit. Moshë, nevojat, interesat e nxënësve duhet të respektohen. Mësuesi nuk është më burimi i vetëm i njohurive dhe informacionit dhe roli i tij nuk është vetëm transferimi i njohurive. Roli i tij është të inkurajojë nxënësit të përdorin burime të tjera të njohurive dhe të informacionit dhe t'i mësojë ata se si të mësojnë. Diferencimi dhe diversiteti duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së aktiviteteve. Duhet të zgjidhen ose të përshtaten aktivitete që janë të përshtatshme me stile të ndryshme të të nxënit (vizuale, auditive, kinestetike); llojeve të ndryshme të inteligjencës (verbale-lingustike, matematiko-logjike, muzikore-ritmike, vizualuale- hapësinore dhe të tjera), si dhe niveleve të njohurive të nxënësve.

Duhet të mirret parasysh se motivimi për të mësuar përmirësohet me përdorimin e formave të ndryshme të punës në mësimdhënie (frontale, individuale dhe punë në çifte dhe grupe), si dhe me ndryshimin e aktiviteteve më të shkurtra dhe më të gjata, më të zëshme dhe më të qeta, poashtu dhe periudhat e vëmendjes së përqëndruar dhe relaksimi i nxënësve gjatë orës së mësimi.

Mësimdhënia në gjuhën angleze bazohet në mësimin holistik që i përfshin aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, konkretisht, mësuesi, duke i integruar komponentët e ndryshëm, ndihmon që gjuha të mësohet në një mënyrë më funksionale. Në pajtim me parimet e lartëpërmendura, në mësimdhënien e gjuhëve të huaja komponentat nuk mund të ndahen dhe kjo do të thotë që nuk mund të planifikohet numri i orëve me komponenta të ndarë.

Mësimdhënia për këtë grupmoshë është e orientuar drejt të mësuarit kognitiv me qartësi të mprehtë të strukturave gjuhësore dhe duke i përdorur ata në kontekst dhe në mënyrë të vetëdijshme si dhe duke integruar gradualisht metagjuhë gramatikore. Gjatë kësaj periudhe, bëhen përpjekje për të zhvilluar njëkohësisht komunikimin verbal dhe atë të shkrimit. Kjo do të thotë që vëmendje të barabartë u kushtohet të gjitha shkathtësive gjuhësore: dëgjimi dhe leximi me të kuptuar, të folurit si në aspektin e ndërveprimit të të folurit ashtu dhe në aspektin e prodhimit të të folurit, si dhe komponentës *Shkrim*.

Mësuesi duhet të inkurajojë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësve përmes aktiviteteve dhe detyrave që u mundësojnë nxënësve të marrin përgjegjësi për mësimnxënien e tyre dhe njohuritë që i marrin në një kontekst zyrtar të të mësuarit (në klasë) dhe t'i përdorin ato jashtë klasës. Kjo do të thotë që në orët mësimore të gjuhës angleze përvetësohen njohuri themelore gjuhësore, njohuri socio-pragmatike por edhe njohuri që kanë të bëjnë me vetë procesin e të mësuarit.

Nga e tëra që u tha mësipër, rezulton se mësuesi duhet t'i mësojë nxënësit se si të mësojnë më lehtë dhe më shpejt, si të mbajnë mend atë që kanë mësuar dhe si të përdorin dijet në situata të reja, jashtë klasës. Mësuesi duhet t'u mësojë nxënësve qëllimet dhe përmbajtjen e aktiviteteve / detyrave / materialeve si dhe strategjitë e të të mësuarit që ata do t'i aplikojnë në nivele më të larta të të mësuarit. Nga mësuesi pritet që t'i mësojë nxënësit të zbatojnë strategji për **nxënie të suksesshme**.

#### **4. Normativa për kuadrin mësimdhënës**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi sipas normativës për kuadrin mësimdhënës që e gjejmë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për vitin shkollor **2020/2021**, për lëndën mësimore **gjuhë angleze** për vitin e **tretë të arsimit të mesëm katërvjeçar**, e verifikon

Ministri i arsimit dhe shkencës,  
Milla Carovska

---